



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:067144

Datë: 16.05.2019

Numri i dokumentit: 00314310

P. nr.800/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.6-1 të KPRK-së Nr.06/I-074 sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.1624/18 të dt.12.11.2018, të ri kualifikuar në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **06.05.2019**, në prani të Prokurorit së shtetit Nazmi Krasniqi si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **SH. B.**, nga Gjakova Rr. " . . " nr. . . , i biri i R. dhe i nënës Sh. e gjinisë T. , data e lindjes . . . , ka te kryer shkollën e mesme, pensionist ,i gjendjes se dobët ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i martuar atë i 4 fëmijëve, me nr.ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- **me datë të pavërtetuar e gjerë me datë 13.07.2018**, në shtëpinë e tij në Gjakovë , . . . , me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 të Ligjit për energjinë elektrike të R. Kosovës , ka shfrytëzuar energjinë elektrike ,në atë mënyrë qe në njehsorin nr. . . , ka hequr pllombat distributive dhe duke qenë i shkyçur nga AMR-ja (shkyçur nga distanca) , është kyçur në rrjetin elektrik duke kryqëzuar hyrjet dhe daljet në njehsor bashkë në një vrimë , me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar , me ç 'rast ndërmarrjes së dëmtuar ,i ka shkaktuar dem ne shume prej 101. 93 euro.

-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.6-1 të KPRK-së, Nr.06/I-074

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,46,49,50,51, 73 ,neni 314 par6-1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara K. D.- Distrikti në Gjakovë ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil .

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet procedurale te përcaktuara nga ana e gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga **20,00-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1624/18 të dt.12.11.2018, ka akuzuar të pandehurin Sh. B. nga Gjakova , për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi , në shqyrtimin fillestar me dt.06.05.2019, lexoi aktakuzën PP/II.nr.1624/18 të dt.12.11.2018, me ç ‘rast deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës, por sa i përket kualifikimit juridik te veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës ,duke marr parasysh se nga dt. 14 prill 2019 ka hyre ne fuq i kodi i ri penale ,ashtu qe duke aplikuar nenin 3 pra 2 te KPRK-ës për zabitin e ligjit me te favorshëm pasi qe sipas nenit 320 te Ish KPRK-ës (kodi i vjetër) për veprën penale me te cilën akuzohet i akuzuari parashihet dënim kumulativ-gjobë dhe burgim , ndërsa sipas kodit te ri penale vepra penal vjedhje e shërbimeve nga neni 314 /6-1 te KPRK-ës është e dënueshme me dënim me gjobë ose me burgim , pra dënueshmëria për këtë veprë është e përcaktuar në mënyrë alternative .Andaj kodi i ri penal dhe vepra penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314/6-1 është më e favorshme për të pandehurin ,andaj edhe beje rikualifikim e veprës penale nga neni 314/6-1 te KPRK-ës ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

I akuzuari Sh. B.,shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, , me qene se një gjendje e tillë është konstatuar nga punëtorët kompetent te K. D.-it ,shtojë se me pranimin e fajësisë është penduar për këtë veprë penale të kryer për shkak te kushteve te dobëta ekonomike ,edhe pse jam munduar ne çdo kohë te beje pagesën e energjisë se shpenzuar ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm ,andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm dhe nuk do te përsëris një veprim te tillë , gjendjen e dobët ekonomike me qene se jetojë me pension , si dhe faktin se me pare nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi ,deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi të fajësisë, nga vet pranimi i fajësisë është vërtetuar ne tërësi gjendja e plote dhe e drejtë faktike si ne dispozitivin e aktakuzës se ri kualifikuar me nr. PP/II.nr. 1624/18 me dt. 12.11.2018, ndërsa sa i përket lartësisë se demit e dëmtuara te udhëzohet ne kontest civil .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari Sh. B.: - me datë të pavërtetuar e gjerë me datë 13.07.2018, në shtëpinë e tij në Gjakovë , RR.” . . .” p.n. , ,me qëllim që veti ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 të Ligjit për energjinë elektrike të R. Kosovës , ka shfrytëzuar energjinë elektrike ,në atë mënyrë qe në njehsorin nr.. . . , ka hequr pllombat distributive dhe duke qenë i shkyçur nga AMR-ja (shkyçur nga distanca) , është kyçur në

rrjetin elektrik duke kryqëzuar hyrjet dhe daljet në njehsor bashkë në një vrimë , me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar , me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar ,i ka shkaktuar dem ne shume prej 101 .93 euro.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është familjarë, babai i katër fëmijëve ,sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte, qytetar i rëndomtë dhe se asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin nuk ka qenë i dënuar., Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, shprehjen e keq ardhjes nga e dëmtuara për veprën e kryer për shkak të kushteve të dobëta ekonomike ,premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet ,të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 74 të KPRK-së. Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.800/18 më datë 06.05.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykatë.

Numri i lëndës: 2018:067144
Datë: 16.05.2019
Numri i dokumentit: 00314310